REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 11 / 26
Datë/Datum. 09.01.2026
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

# RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

| *Majlinda Bedrolli eks. Shqyrtues* | *Data e autorizimit të ekspertit 12.12.2025* | *Data e dorëzimit të raportit 09.01.2026* | *Nr. i lëndës: 1219/25* |
|---|---|---|---|

## 1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.12.2025, Operatori ekonomik "Arsimi Company SH.P.K –Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr:1219/25, kunder njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në Komunën e Shtimes" - me numër të prokurimit: 617-25-8164-2-2-1., iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Shtime.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbim. Vlera e parashikuar 70,000.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Data e njoftimit për kontratë 05.09.2025, data e hapjes së ofertës 18.09.2025, vendimi i autoritetit kontraktues për anulim 04.12.2025.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më **Nr. 2025/1063 i dt:20.11.2025**.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## 2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, sic janë
Neni 6, 7, 59, 60 dhe 108/A të LPP-së.

**DEKLARATA DETALE E ANKESES**

Pas refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim dhe për eliminimin e kompanisë tonë nga procedura e prokurimit "Mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në Komunën e Shtimes" me numër të prokurimit 617-25-8164-2-2-1 jemi të obliguar të paraqesim ankesë në OSHP kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna Shtime, datë 04.12.2025 për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Ne si Operator Ekonomik kontestojmë këtë vendim si:të kundërligjshëm,të paarsyetuar,të pabazuar në fakte,të mbështetur në pretendime të pavërteta,të bërë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik,shkelës të parimit të transparencës, barazisë dhe trajtimit të drejtë,me elemente të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

**Pretendimi Ankimor numer 1.** Ngarkues me goma, maksimumi 5 ton, një (1) copë-Pika C Me rastin e dorëzimit të ofertës sonë brenda afatit ligjor, kemi ngarkuar plotësisht të gjitha dokumentet e kërkuara nga dosja e tenderit dhe nga njoftimi për kontratë, përfshirë: Librezen e regjistrimit për pajisjen Ngarkues me goma max 5 ton (pika C),Kemi bashkangjitut edhe fotografit e paisjes. Me datën 02.12.2025, Autoriteti Kontraktues ka dërguar Kërkesë për Sqarim, ku është kërkuar nga ana e kompanise tonë dorëzimi i të njëjtave dokumente që tashmë gjendeshin në ofertën tonë të dorëzuar fillimisht. Pra,pavarësisht se këto dokumente EKZISTONIN dhe ishin DORËZUAR në ofertën fillestare, ne me datë 03.12.2025, i kemi dorëzuar PËRSËRI të gjitha dokumentet e kërkuara, të plota, të sakta dhe të vlefshme,përmes platformes elektronike e-prokurim, DHE Vendimi për eliminimin e kompanisë tonë ,vendim i datës 04.12.2025 është abuziv, i paarsyetuar dhe cenon rëndë parimet e barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë.

Edhe në vendimin e kërkesen për ri-shqyrtim, AK pretendon: Dokumentet nuk e dëshmojnë pajisjen. Mirëpo faktet reale,argumentojnë të kundërten,sepse ne kemi ngarkuar: • Librezën e regjistrimit e kemi ngarkuar dhe aty figuron qartë përshkrimi "Lugë ngarkuese"; •Pesha e pajisjes është 4,250 kg, pra brenda kriterit të kërkuar (≤5 ton). • Fotografitë e pajisjes e dëshmojnë identitetin e saj pa asnjë dyshim, dhe Pajisja gjendet fizikisht në dispozicion dhe është 24/7 për verifikim nga AK.

Është shumë e lehtë të verifikohet identiteti i pajisjes tonë, pasi si emërtimi i pajisjes në librezën e regjistrimit

ashtu edhe numri identifikues i saj , e bëjnë të pamundur ngatërrimin me ndonjë pajisje tjetër. Çdo organ verifikues mund të konstatojë menjëherë se pajisja jonë është pikërisht "Lugëngarkuese me goma ≤5 ton", siç kërkohet nga dosja e tenderit. AK nuk e ka lexuar fare dokumentin ose ka vendosur të mos e lexojë, duke dhënë arsye të pavërteta.Pra ky është refuzim i paarsyetuar, që bie ndesh me nenin 59 të LPP-së.

**Pretendimi numer 2.** Eskavator me lugë rrafshuese (levizëse në dy anë), kapacitet 1 m³, minimum 15 tonë-Pika G. Me rastin e dorëzimit të ofertës sonë brenda afatit ligjor, kemi ngarkuar plotësisht të gjitha dokumentet e kërkuara nga dosja e tenderit dhe nga njoftimi për kontratë, përfshirë edhe për këtë pajisje kemi dorëzuar të gjitha dokumentet: •Dudin doganor, •Fotografitë e pajisjes, •Marrëveshjet për shfrytëzim. Me datën 02.12.2025, Autoriteti Kontraktues ka dërguar Kërkesë për Sqarim, ku është kërkuar nga ana e kompanise tonë dorëzimi i të njëjtave dokumente që tashmë gjendeshin në ofertën tonë të dorëzuar fillimisht, për të shmangur edhe dyshimin më të vogël, më datë 03.12.2025 ne dorëzuam përsëri të gjitha dokumentet, të plota dhe të lexueshme. Pra,pavarësisht se këto dokumente EKZISTONIN dhe ishin DORËZUAR në ofertën fillestare, ne me datë 03.12.2025, i kemi dorëzuar PËRSËRI të gjitha dokumentet e kërkuara, të plota, të sakta dhe të vlefshme,përmes platformes elektronike e-prokurim, DHE vendimi për eliminimin e kompanisë tonë ,vendim i datës 04.12.2025 është abuziv, i paarsyetuar dhe cenon rëndë parimet e barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë. Konkretisht:Vendimi është i rremë dhe në kundërshtim me faktet,SEPSE: AK në vendimin e kërkesës për ri-shqyrtim, pretendon se: •Dokumentet nuk dëshmojnë karakteristikat teknike, •Pajisja qenka "34.800 ton", •Nuk paska rrotullim 360°, dhe kjo qenka problem. Mirëpo faktet reale,argumentojnë të kundërten,sepse • Rrotullimi 360° nuk është kërkuar askund pra AK ka shpikur kriter të ri (shkelje e pastër e nenit 59). • Kapaciteti i lugës 1 m³ është i vërtetuar me tiketë teknike dhe fotografi. • Pajisja ka lugë rrafshuese, levizëse në dy anë, plotësisht në përputhje me kriteret e tenderit. • Pretendimi për peshë 34.800 ton është teknikisht i pamundur (kjo peshë i takon anijeve industriale, jo eskavatorëve). •Kriteri i dosjes ishte minimum 15 ton dhe Pajisja jonë e plotëson kriterin ≥15 ton pa asnjë paqartësi. Pra,AK ka shpikur kritere, ka interpretuar në mënyrë të rreme dhe ka dhënë arsye që nuk ekzistojnë në dosjen e tenderit.Ky është veprim arbitrar dhe shkelje flagrante e LPP-së. Fotografitë e pajisjes, të cilat i kemi dorëzuar si gjatë ofertimit ashtu edhe gjatë përgjigjes ndaj Kërkesës për Sqarim, e dëshmojnë pa asnjë dyshim se eskavatori është i pajisur me lugë rrafshuese levizëse në dy anë. Kjo karakteristikë është e dukshme, e verifikueshme vizualisht dhe mund të konfirmohet lehtësisht nga çdo ekspert i fushës së mekanizimit.

**Pretendimi Ankimor numer 3.** Eskavator me zinxhir goma, minimum 8–10 ton (1 copë)-Pika H. Me rastin e

dorëzimit të ofertës sonë brenda afatit ligjor, kemi ngarkuar plotësisht të gjitha dokumentet e kërkuara nga dosja e tenderit dhe nga njoftimi për kontratë, përfshirë: Me ofertën tonë kemi dorëzuar:Dudin doganor,Fotografitë e pajisjes,Dokumente të tjera përkatëse Edhe këtu, AK kërkon sërish dokumentet ekzistuese. Ne i dorëzojmë edhe një herë më 03.12.2025. Autoriteti Kontraktues në përgjigjen e kërkeses për ri-shqyrtim, pretendon: se dokumenti paska qenë për "Mini Eskavator". Ky pretendim është i pavërtetë. Sepse faktet reale,argumentojnë të kundërten: •Në dokumentin doganor figuron qartë përshkrimi "Track Excavator", që do të thotë Eskavator me zinxhir JO "mini". •Pesha është 8,779 kg, pra brenda kriterit 8–10 ton. •Askund, në asnjë dokument, nuk figuron termi "Mini Eskavator". Ky është krijim i AK-së. Dokumentet janë zyrtare, me datë, me vulë dhe plotësisht të verifikueshme. Pra, pretendimi i AK është i pavërtetë, i fabrikuar dhe tregon që vendimi nuk është marrë mbi bazën e dokumenteve reale.Kjo është shkelje e rëndë e neneve 7, 59 dhe 61 të LPP-së. Fotografitë e bashkëngjitura nga kompania jonë, si me rastin e ofertimit ashtu edhe me rastin e përgjigjes ndaj Kërkesës për Sqarim, dëshmojnë 100% se pajisja është eskavator me zinxhir gome, pikërisht sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Çdo element vizual konfirmon llojin e zinxhirit pa asnjë paqartësi. Po ashtu, dudi doganor e vërteton qartë peshën reale të pajisjes (8,779 kg), duke provuar përputhjen e plotë me kriterin 8–10 ton. Këto të dhëna e bëjnë të pamundur ngatërrimin me "mini eskavator" dhe rrëzojnë plotësisht pretendimin e pavërtetë të AK-së.

I nderuar ekspert/e dhe panel shqyrtues, këtu kemi të bejmë me nje Autoritet Kontraktues I cili bënë shkelje të kategorisë së rënda ligjore, Sepse: •Egziston shpikja e kritereve teknike që nuk ekzistojnë në tender. •Moslexmi i dokumenteve zyrtare të dorëzuara dy herë. •Keqinterpretimi i qëllimshëm i peshave dhe karakteristikave teknike. •Trajtim i pabarabartë -pasi i njëjti AK ka shpërblyer një OE tjetër pa libreza dhe pa dokumenta doganore( vendimin te cilin e ka obliguar OSHP Autoritetin Kontraktues, ne baze te vendimit nr 2025/1063) ngase AK do te kishte vazhduar të shperblente me kontratë OE të papergjegjshem,pavarsisht që OE si plotesonte kriteret) •Tendencë e dukshme për të mos lejuar shpërblimin tonë, duke tentuar edhe anulimin e aktivitetit në ri-vlerësim. •Vendimmarrje arbitrare, në kundërshtim me transparencën dhe proporcionalitetin. •Cenim i konkurrencës dhe i integritetit të prokurimit publik. •Abuzim i mundshëm me pozitën zyrtare. Në përmbyllje, ju njoftojmë se të gjitha dokumentet relevante janë të bashkëngjitura në fund të kërkesës për ri-shqyrtim, përfshirë: librezat e regjistrimit, dokumentet doganore (dudat) për secilën pajisje, marrëveshjet për shfrytëzim si dhe materialet plotësuese të kërkuara. Këto dokumente zyrtare dhe plotësisht të verifikueshme dëshmojnë në mënyrë të qartë, të plotë dhe të pakontestueshme se kompania jonë i ka përmbushur në përpikëri absolute të gjitha kriteret e dosjes së tenderit Këto shkelje konsiderojme që

mjaftojnë që OSHP të konstatojë anulim të vendimit dhe kthim në ri vlerësim.

KËRKOJMË NGA OSHP, që të merrë V E N D I M APROVOHET si e bazuar Ankesa e ARSIMI COMPANY SH.P.K. Anulimin në tërësi të vendimit të Komunës së Shtimes, datë 04.12.2025. Obligimin e AK-së për ri-vlerësim të ligjshëm dhe të paanshëm, duke marrë parasysh dokumentet e dorëzuara.

## 3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

## 4. RAPORTI I KOMISIONIT RI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues me dt 04.12.2025, ka konstatuar si në vijim: Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Shtime-Anulohet kjo procedur e prokurimit pasi që OE të cilët kanë konkuruar në këtë aktivitet nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

## 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

**Vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2025/1063 i dt:20.11.2025.**

## 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

## 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

**<u>Sqarim hyrës:</u>** Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për anulim të aktivitetit, ku kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP (kundër dhënies së kontratës), ndërsa **ekspertja shqyrtuese** ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.1063/2025, të datës 12.11.2025. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me **Vendimin PSH.nr.1063/2025, të datës 20.11.2025**, ku është arritur pajtimi në mes palëve në

cilësinë e Autoritetit Kontraktues Komuna e Shtimes dhe Operatorit ekonomik "Arsimi Company SH.P.K – Ferizaj".

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 6,7, 59, 60 dhe 108/A, të LPP-së. OE ankues së bashkur me ankes të dorzuar në OSHP ka bashkangjitur prova lidhur me pajisjet.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 04.12.2025. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe jep përgjigje si në vijim.

**Pretendimi ankimor 1:** 1. Ngarkues me goma, maksimumi 5 ton, një (1) copë-Pika C

OE ankues pretendon me rastin e dorëzimit të ofertës brenda afatit ligjor, ka ngarkuar të gjitha dokumentet e kërkuara nga dosja e tenderit dhe nga njoftimi për kontratë, përfshirë: Librezën e regjistrimit për pajisjen Ngarkues me goma max 5 ton (pika C), kemi bashkangjitur edhe fotografit e pajisjes. Me datën 02.12.2025, Autoriteti Kontraktues ka dërguar Kërkesë për Sqarim, ku është kërkuar nga ana e kompanisë tonë dorëzimi i të njëjtave dokumente që tashmë gjendeshin në ofertën tonë të dorëzuar fillimisht, pavarësisht se këto dokumente ekzistonin dhe ishin dorëzuar në ofertën fillestare, ne me datë 03.12.2025, i kemi dorëzuar përsëri të gjitha dokumentet e kërkuara, të plota, të sakta dhe të vlefshme, përmes platformës elektronike e-prokurim, dhe Vendimi për eliminimin e kompanisë tonë, vendim i datës 04.12.2025 është abuziv, i paarsyetuar dhe cenon rëndë parimet e barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë. Edhe në vendimin e kërkesën për ri-shqyrtim, AK pretendon: Dokumentet nuk e dëshmojnë pajisjen. Mirëpo faktet reale, argumentojnë të kundërtën sepse ne kemi ngarkuar:

- Librezën e regjistrimit e kemi ngarkuar dhe aty figuron qartë përshkrimi "Lugë ngarkuese";
- Pesha e pajisjes është 4,250 kg, pra brenda kriterit të kërkuar (≤5 ton).
- Fotografitë e pajisjes e dëshmojnë identitetin e saj pa asnjë dyshim, dhe pajisja gjendet fizikisht në dispozicion dhe është 24/7 për verifikim nga AK. Është shumë e lehtë të verifikohet identiteti i pajisjes tonë, pasi si emërtimi i pajisjes në librezën e regjistrimit ashtu edhe numri identifikues i saj e bëjnë të pamundur ngatërrimin me ndonjë pajisje tjetër. Çdo organ verifikues mund të konstatojë menjëherë se pajisja jonë është pikërisht "Lugëngarkuese me goma ≤5 ton", siç kërkohet nga dosja e tenderit. Tutje, OE ankues potencon se AK nuk e ka lexuar fare dokumentin ose ka vendosur të mos e lexojë, duke dhënë arsye të pavërteta. Pra, ky është refuzim i paarsyetuar, që bie ndesh me nenin 59 të LPP-së.

**Përgjigje në pretendimin ankimor 1. Ekspertja shqyrtuese** sqaron se në dosje të tenderit, tek "Kapaciteti teknik dhe professional", Kërkesa 5, pika c, AK ka kërkuar: ***"Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë"***. Si dëshmi dokumentare është kërkuar: *"Deshmia 5.Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur original) operatori ekonime per autojmetet duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne original* ***si dëshmi kopjet e dokumetit te registrimit per mjetet nga pika (a-e) dhe libreza****, dud doganor, fatur etj per mjetet nga pika (f-I).*".

**Ekspertja shqyrtuese** sqaron se kërkesa e AK ka qenë "një ngarkues me goma, maksimumi 5 ton", ku OE duhet të dëshmoj listën e pajisjeve me kopje të regjistrimit për mjetet nga pika **a** deri në pikën **e**, si dhe me libreza, dud doganor dhe faturë për mjetet nga pika **f** deri në pikën **i**. Bazuar në ofertën e OE ankues, konkretisht në dokumentet me titull **"8.) Makinerit.zip"**, **"Marrveshja Ngarkuesi.pdf"** për pajisjen ***"Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë"*** si dëshmi dokumentare OE ankues ka ofruar "Marrëveshjen për qiramarrje të mekanizmit" dhe Certifikatën e regjistrimit të automjetit (librezën e regjistrimit) me nr. të targave 05-764-VA me afat të regjistrimit deri me datë 14.06.2026, si dhe një fotografit të pajisjes. Bazuar në dëshmitë e cekura si më lart, ekspertja shqyrtuese vlerëson e OE ankues plotëson kërkesën e AK-së. Andaj, pretendimi ankimor **është i bazuar**.

**Provë:**

# Arsimi Company SH.P.K.

Mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në Komunën e Shtimes
Nr.Prokurimit: 617-25-8164-2-2-1

| Nr. | Lloji i Pajisjes | Sasia e kërkuar | Sasia që ofron ofertuesit | Të dhënat për pajisjet | Pronësia |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kamion kiper me kapacitet min 15ton min. 2 cope | 2 | 2 | ACTROS 3244 (05-978-HG) | Arsimi Company SH.P.K. |
| | | | | ACTROS 3244 K 8X4/4(05-507-GT) | Bageri SH.P.K. |
| 2 | Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë | 1 | 1 | ZETTELMEYER ZL 502 (05-764-VA) | Avdi Salihu B.I. |
| 3 | Greder min 14-16ton min. 1 copë | 1 | 1 | HBM 999 (AI MT 87) | PEPA GROUP SH.P.K. |
| 4 | Eskavator min 20ton min 2 copë | 2 | 2 | LIEBHERR R918 | Arsimi Company SH.P.K. |
| | | | | LIEBHERR R 906 LC LITRONIC | Arsimi Company SH.P.K. |
| 5 | Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t min 1 copë | 1 | 1 | LIEBHERR R936 LC | Eurokos Holding SH.P.K. |
| 6 | Eskavator me zingjir gome min 8-10ton min 1 cop | 1 | 1 | VOLVO ECR88D | Arsimi Company SH.P.K. |
| 7 | Eskavator me zingjir gome deri 1ton min. 2 copë | 2 | 2 | Rhino-cross, R319C,Nr.Serik:SIP24041402 | Eteam SH.P.K. |
| | | | | Maxima, T8108 | Gzim Kolgeci |
| 8 | Rul per ngjeshje te dheut min 13t min 1 copë | 1 | 1 | HAMM 4011 | Arsimi Company SH.P.K. |
| 9 | Cilinder min 5, min 1 | 1 | 1 | HAMM 3011 D | Arsimi Company SH.P.K. |

ARSIMI COMPANY SH.P.K.

| Valid to | Valid to |
|---|---|
| 14.06.2025 | 14.06.2026 |
| Official signature | Official signature |
| Valid to | Valid to |
| Official signature | Official signature |
| Valid to | Valid to |
| Official signature | Official signature |

REPUBLIKA E KOSOVËS
РЕПУБЛИКА КОСОВО
REPUBLIC OF KOSOVO

# RKS

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË AUTOMJETIT
УВЕРЕЊЕ РЕГИСТРАЦИЈЕ,ВОЗИЛА
VEHICLE REGISTRATION CERTIFICATE

**05-764-VA**

| | | |
|---|---|---|
| A | Registration number | 05-764-VA |
| I | Registration date | 18.06.2024 |
| C | | |
| C.2 | Owner of the vehicle | |
| C.2.1 | | Avdi Salu B.I. |
| C.2.2 | Name | |
| C.2.3 | Address | Brahim Ademi, 1002 Ferizaj |
| B | Date of first registration | 01.10.1994 |
| D | | |
| D.1 | Make | ZETTELMEYER |
| D.2 | Type | ZL 502 |

| | | |
|---|---|---|
| CG | | |
| E | | 6121096 |
| S | Year of production | 1994 |
| S | | 1 |
| S.1 | Number of seats | |
| S.2 | Number of standing places | |
| Q | | |
| F | | |
| F1 | | |
| G | Mass of the vehicle | 4250 |
| K | Type of approval | |

| | | |
|---|---|---|
| P | Engine | |
| P1 | Capacity (in cm3) | 2730 |
| P2 | Maximum net power (in kW) | 33,00 |
| P3 | | Dizel |
| R | Colour of the vehicle | X - SHUMËNGJYRËSH |
| ZA | Construction | Eskavator me 2 dyer |

Remarks:

N.T.SH. " PËRPARIMI "
Lugë ngarkuese



**Pretendimi ankimor 2:** Eskavator me lugë rrafshuese (lëvizëse në dy anë), kapacitet 1 $m^3$, minimum 15 tonë-Pika G.

OE ankues pretendon me rastin e dorëzimit të ofertës brenda afatit ligjor ka ngarkuar plotësisht të gjitha dokumentet e kërkuara nga dosja e tenderit dhe nga njoftimi për kontratë, përfshirë edhe për këtë pajisje kemi dorëzuar të gjitha dokumentet:

- Dudin doganor,
- Fotografitë e pajisjes,
- Marrëveshjet për shfrytëzim.

Me datën 02.12.2025, Autoriteti Kontraktues ka dërguar Kërkesë për Sqarim, ku është kërkuar nga ana e kompanisë tonë dorëzimi i të njëjtave dokumente që tashmë gjendeshin në ofertën tonë të dorëzuar fillimisht, për të shmangur edhe dyshimin më të vogël, më datë 03.12.2025 ne dorëzuam përsëri të gjitha dokumentet, të plota dhe të lexueshme, pavarësisht se këto dokumente ekzistonin dhe ishin dorëzuar në ofertën fillestare, ne

me datë 03.12.2025, i kemi dorëzuar përsëri të gjitha dokumentet e kërkuara, të plota, të sakta dhe të vlefshme, përmes platformës elektronike e-prokurim, dhe vendimi për eliminimin e kompanisë tonë ,vendim i datës 04.12.2025 është abuziv, i paarsyetuar dhe cenon rëndë parimet **e barazisë, transparencës dhe** trajtimit të drejtë. Konkretisht: Vendimi është i rremë dhe në kundërshtim me faktet, SEPSE:AK në vendimin e kërkesës për ri-shqyrtim, pretendon se: Dokumentet nuk dëshmojnë karakteristikat teknike, Pajisja qenka "34.800 ton", Nuk paska rrotullim 360°, dhe kjo qenka problem. Tutje, OE ankues shton se faktet reale, argumentojnë të kundërtën, sepse • Rrotullimi 360° nuk është kërkuar askund pra AK ka shpikur kriter të ri (shkelje e pastër e nenit 59). • Kapaciteti i lugës 1 $m^3$ është i vërtetuar me tiketë teknike dhe fotografi.

• Pajisja ka lugë rrafshuese, lëvizëse në dy anë, plotësisht në përputhje me kriteret e tenderit.

• Pretendimi për peshë 34.800 ton është teknikisht i pamundur (kjo peshë i takon anijeve industriale, jo eskavatorëve).

• Kriteri i dosjes ishte minimum 15 ton dhe Pajisja jonë e plotëson kriterin ≥15 ton pa asnjë paqartësi. Pra, AK ka shpikur kritere, ka interpretuar në mënyrë të rreme dhe ka dhënë arsye që nuk ekzistojnë në dosjen e tenderit. Ky është veprim arbitrar dhe shkelje flagrante e LPP-së.

Fotografitë e pajisjes, të cilat i kemi dorëzuar si gjatë ofertimit ashtu edhe gjatë përgjigjes ndaj Kërkesës për Sqarim, e dëshmojnë pa asnjë dyshim se eskavatori është i pajisur me lugë rrafshuese levizëse në dy anë. Kjo karakteristikë është e dukshme, e verifikueshme vizualisht dhe mund të konfirmohet lehtësisht nga çdo ekspert i fushës së mekanizimit

**Përgjigje në pretendimin ankimor 2. Ekspertja shqyrtuese** sqaron se në dosje të tenderit, tek "Kapaciteti teknik dhe professional", Kërkesa 5, pika g, AK ka kërkuar: ***"g. Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special për hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t min 1 copë"***. Si dëshmi dokumentare është kërkuar: *"Deshmia 5.Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur original) operatori ekonime per autojmetet duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne original si **deshmi kopjet e dokumetit te registrimit per mjetet nga pika (a-e) dhe libreza**, dud doganor, fatur etj per mjetet nga pika (f-I).".*

**Ekspertja shqyrtuese** sqaron se kërkesa e AK ka qenë "një Eskavator me lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët për hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 dhe minimumi 15 ton", ku OE duhet të dëshmoj listën e pajisjeve me kopje të regjistrimit për mjetet nga pika **a** deri në pikën **e**, si dhe me libreza, dud doganor dhe faturë për mjetet nga pika **f** deri në pikën **i**.

Bazuar në ofertën e OE ankues, konkretisht në dokumentin me titull **"Marrveshja Eurokos_.pdf",** është

bashkangjitur marrëveshja për marrjen me qira nga për pajisjen ***"Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special për hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t min 1 copë"***, ndërsa si dëshmi dokumentare ka ofruar **DUD-in doganor**, në të cilin jepen specifikat e pajisjes, fatura e blerjes së kësaj pajisje nga qiradhënësi, dëshmia e pagesës së doganës për këtë pajisje dhe specifikacioni teknik i pajisjes. Në bazë të këtyre dëshmive të bashkangjitura, pretendimi i OE ankues është **i bazuar.**

**Provë:**

# MARRVESHJE PER QIRAMARRJE TE MEKANIZMIT

E lidhur me datë 18.09.2025,në mes të palëve kontraktuese:

- ARSIMI COMPANY SH.P.K. me Numer biznesi: 812032770 Komuna FERIZAJIT , të cilën e përfaqëson drejtori Arsim Ahmeti (Qiramarrësi)
- EUROKOS HOLDING SH.P.K. me Numer biznesi: 810520115 nga Komuna e Prishtinës, te cilën e përfaqson Ylber Shamolli (Qirdhënës)

PERMBAJTJA E MARRVESHJES

Lëndë baze e kesaj marrëveshje është: Marrja me qira e Paisjeve

1. **Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t – Liebherr R936 LC**

**sipas kërkesës për tenderin me titull:**

**Mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në Komunën e Shtimes**

**Nr. prokurimit: 617-25-8164-2-2-1**

SIGURIA NE PUNE

Zbatuesi duhet t'i parasheh të gjitha masat mbrojtese për puntorët e vetë në bazë të ligjit të aplikueshem në Kosovë dhe standarteve të BE-së. Porositësi në asnjë mënyrë nuk do të jetë përgjegjës për aksidentinet eventuale që do të ndodhin gjatë procesit në punë të paisjeve.

KUALITETI DHE KOHEZGJATJA

Validiteti i kesaj marrveshje eshte deri ne perfundimin e kontrates ne terësi prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.

QMIMI

Qmimi për përdorimin e makineris është i bazuar në ditë ( 15 Euro ).

INTERPRETIMI JURIDIK

Në rast të kontestit eventual gjatë aplikimit ose interpretimit të ndryshëm të kësaj marrveshjeje , palët nënshkruese pajtohen që kontekstin së pari ta zgjidhin bashkarisht dhe në pamundësi të kësaj të zgjidhet nga Gjykata Ekonomike në Prishtine .

Efekti juridik i kesaj marrveshje bashkpunimi fillon me datën e nënshkrimit të dy palëve . Ndryshimet eventuale dhe përplotësimet eventuale të kësaj marrvveshjeje bashkepunimi bëhen me shkrim në formë amandamenti ,i cili do të konsiderohet si pjesë përbërëse e kesaj marrveshjeje.

Kjo marrëveshje bashkpunimi është hartuar nëdy ekzemplarë identikë, ku secila pale nënshkruese e këtij dokumenti e merr nga një kopje.

NENSHKRUESIT:

(Arsim Ahmeti) ARSIMI COMPANY SH.P.K.

(Ylber Shamolli)EUROKOS HOLDING SH.P.K

24-BU01-001-24

Dokumenti Unik Doganor

ZYRA E DESTINIMIT: 2060 ZBD FERIZAJ

1 DEKLARATË: IM | 4

Referenca doganore: R 37776 — 30/12/2024

Manifesti: 2024 21000

3: 1 | 1

5 Artikuj: 1 — 6 Nr. pakove: 1 — 7 Numri referues: 2024 #3398

2 Eksportuesi: M IT ABUALI, 66802 UBERHEIM/DE

8 Marrësi / Importuesi — Nr 810520115: EUROKOS HOLDING SH.P.K., Prishtinë Migjeni Nr.23/1, Prishtinë

9 Personi përgjegjës — Nr 810520115: EUROKOS HOLDING SH.P.K., Prishtinë Migjeni Nr.23/1, Prishtinë

10 Vendi: XK — 11 Vendi: XS — 12 Detajet e vlerës: 0.00 — 13 P.P.B: 1

14 Deklaruesi — Nr 810644337: NTSH,, Albini " Driton Islami, Ferizaj

15 Vendi dërgues/eksportues: GJERMANIA — 15 V.E. Kodi: a DE — 17 V.D. Kodi: a XK

16 Vendi origjinës: GJERMANIA — 17 Vendi i destinacionit: KOSOVA

18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në: VR164JF OO413VR XS — 19: jo

20 Kushtet e dorëzimit: EXW DE

21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon: VR164JF OO413VR XS

22 Valuta dhe shuma e: EUR 60,000.00 — 23 Kursi i: 1.0000000 — 24 Lloji i: 1 | 1 transakc.

25 Lloji: 30 — 26 Lloji: 30 Transporti — 27 Transportuesi

28 Të dhëna financiare dhe bankare

29 Zyra doganore hyrëse/dalëse: 3041 PKK DHEU I BARDHË — 30 Lokacioni i mallrave

31 Pakoizimi dhe përshkrimi i mallit — Shenjat dhe numrat - Nr i kontejnerit - Numri dhe lloji

Shenja & nr: WLHZ1490HZC047594

Kontejner

Numri dhe: 1 NG

Lloji: Pa paketim

Makineritë me rrotullim të superstrukturës 360°, eskavatorët track -

Marka:Liebherr,Tipi:R936 LC
Kw-170,Dyer-1,Ulese-1,Ngjyra Verdhe
Ore-12886,Viti Prodhimit:2019

32 Artikull: 1 — 33 Numri tarifor: 84295210 00

34 Kodi origjinës: a DE — 35 Pesha bruto (kg): 34,800.00 — 36

37 Procedura: 4000 000 — 38 Pesha Neto (kg): 34,800.00 — 39 Kuota

40 Dokumenti paraprak/deklar. përmbledhës: 1

41 Njësia plotësuese: PCE 1.00 — 42 Çmimi për njësi: 60,000.00 — 43 M.V.: 6

Kodi LSH — 45 Rregullimi: 1.869

46 Vlera Statistikore: 114,009.00

44 Inf. Dokumenta Certifikata dhe Autorizime: Nr. Licencës — D.Vle. — D.Ska

1,000.00+0.00+0.00+0.00-0.00

0 380 934 935

380-NR.RG20240229

47 Llog. taksave

| Lloji | Baza e taksës | Norma | Shuma | M |
|---|---|---|---|---|
| CD | 114,009.000 | 0.000 | 0.00 | 1 |
| VT | 114,009.000 | 18.000 | 20,521.62 | 1 |
| | Totali | | 20,521.62 | 1 |

48 Llogaria e pagesës — 49 Identifikimi i depos

B DETAJET E LLOGARISE

| | | | |
|---|---|---|---|
| Mënyra e pagesës | KESH | | |
| Numri i Pranimit | L 37760 | Data | 30/12/2024 |
| Numri Pagesës | P 19779 | Data | 30/12/2024 |
| Garancioni | 0.00 | EUR | Data |
| Totali | 0.00 | EUR | |
| Totali taksave | 20,521.62 | EUR | |

50 Principali — Nr — Nënshkrimi

C ZYRA E NISJES

Përfaqësuar nga: Vendi dhe data

51 Zyrat e tranzitit vendi

52

Kodi — 53 Zyra e destinacionit dhe vendi

D KONTROLL NGA ZYRA DOGANORE E DESTINACIONIT — Vula:

Nënshkrimi

Seala

54 Vendi dhe data

Deklaruesi emri i përfaqësuesit: MUHAMED BEQIRI M80978

NOSHARRJA TREGTARE SHPEDICION ALBINI FERIZAJ

EUROPÄISCHE UNION

## BETRIEBSKONTINUITÄT - AUSFUHRBEGLEITDOKUMENT - LISTE DER POSITIONEN

Vordrucke: 2 | 2

24DE930349427907B7

| Feld | Inhalt |
|---|---|
| Positionsnummer [11 03] | 1 |
| Referenznummer/UCR [12 08] | |
| Versender [13 02] | |
| Empfänger [13 03] | |
| Zusätzlicher Beteiligter in der Lieferkette [13 14] | |
| Ausfuhrland [16 07] | DE |
| Bestimmungsland [16 03] | XK |
| Ursprungsland [16 08] | FR |
| Versendungsregion [16 10] | 99 |
| Beförderungskosten (Zahlungsart) [14 03] | |
| Bewilligung [12 12] | |
| Vorpapier [12 01] | |
| Sonstiger Verweis [12 04] | |
| Warenbezeichnung [18 05] | 1 Stück - Bagger auf Gleisketten (Kettenbagger), selbstfahrend, mit zum 360° drehbarem Oberwagen, gebraucht - LIEBHERR R938 LC - Baujahr: 2019 - Serien-Nr. 1490-47594 |
| Art und Anzahl der Packstücke, Versandzeichen [18 06] | PP 1 1490-47594 |
| CUS-Nummer [18 08] | |
| UN-Nummer [18 07 000] | |
| Warennummer [18 09] | 84295210 |
| TARIC-Code [18 09 056] | 00 |
| Nat. Zusatzcode [18 09 058] | 00 |
| Statistischer Wert [99 06] | |
| Menge bes. Maß [18 08] | 1 |
| Art des Geschäfts [99 05] | |
| Rohmasse [18 04] | 34800 |
| Eigenmasse (kg) [18 01] | 34800 |
| Beantragtes Verfahren [11 09 001] | 10 |
| Vorh. Verf. [11 09 002] | 00 |
| Zusätzl. Verf. [11 10] | |
| Zölle und Abgaben [14 03] | |
| Gesamtabgabenbetrag [14 ..] | |
| Unterlagen [12 03] | [N325] FR20240080 |
| Zusätzliche Informationen [12 02] | |

# Technical specs - R 936 Liebherr

Specification | Accessories | Datasheets

## Specification

Notice: Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

| | | | |
|---|---|---|---|
| Weight | 30.9 t | Transport length | 10.2 m |
| Transport width | 2.39 m | Transport height | 3.13 m |
| Bucket capacity | 1 m³ | Undercarriage | NLC |
| Track width | 600 mm | Boom | MB |
| Max. Reach horizontal | 10.1 m | Dredging depth | 6.45 m |
| Tear-out force | 143 kN | Bucket width | 1.05 m |
| Model series | R | Engine manuf. | Liebherr |
| Engine type | D934 A7 | Engine power | 160 kW |
| Displacement | 7 l | Revolutions at max torque | 1800 rpm |
| No. of cylinders | 4 | Cylinder bore x stroke | 122x150 mm |
| Emission level | IIIB | | |

**More technical details,** like: bucket capacity min., bucket capacity max., dimension lxwxh, max. torque are available in the full technical specs.

Basic model incl. ROPS cabin, traction drive, standard boom and standard bucket

ABUALI GmbH
Machinery International Trading
BAUMASCHINEN / NUTZFAHRZEUGE

MIT Abuali GmbH · Langwies 25a · 66802 Überherrn

EUROKOS Holding Shpk
ID. 810520115
Migjeni 23/1
10000 Prishtina
KOSOVO

ORIGINAL

MIT Abuali GmbH
Langwies 25a
66802 Überherrn

+49 (0) 6836 9213555
+49 (0) 6836 9213550
info@mi-trading.de
www.mi-trading.de

Bank: levoBank eG
IBAN: DE16 5939 3000 0001 4168 04
BIC: GENODE51LEB
USt-IDNr: DE 815 871 889

# Rechnung Nr. RG20240229

Bitte geben Sie bei Zahlung und Kontaktaufnahme die Belegnummer an.

Überherrn, 23.12.2024

Kundennummer: 10968
Leistungsdatum: 23.12.2024

Bearbeiter: Ute Entinger
Bearbeiter Mail: ute@mi-trading.de
Bearbeiter Tel.: 06836-9213555

Hiermit bestätigen wir Ihnen folgende Auftragspositionen.

| Pos. | Bezeichnung | Steuer | Menge ME | Einzelpreis | Gesamtpreis |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kettenbagger Liebherr R936LC<br>Seriennummer: 1490-47594<br>Baujahr: 2019 | 0.00 % | 1,00 Stk | 60.000,00 | 60.000,00 |

| | |
|---|---|
| Zwischensumme EUR | 60.000,00 |
| zzgl. MwSt 0,00 % | 0,00 |
| **Endsumme EUR** | **60.000,00** |

Es handelt sich um eine steuerfreie Ausfuhrlieferung im Sinne §4Nr1b, §6UStG.

Zahlungsvereinbarungen:
Per Rechnung
Vorkasse

Preis ab Standort 66802 Überherrn.
Rechnungsbetrag in Höhe von 60.000,00 € am 23.12.2024 auf o.g. Konto eingegangen.

Besondere Vereinbarungen:
Der o.g. Artikel wurde vom Käufer Probegefahren und Begutachtet. (bzw. Zustand ist dem Käufer bekannt).
Der o.g. Artikel wird unter Ausschluss jeglicher Gewährleistung und Garantie verkauft.
Der o.g. Artikel ist frei von Rechten dritter Personen.
Der o.g. Artikel bleibt bis zur vollständigen Bezahlung Eigentum der Firma MIT Abuali GmbH.

ABUALI
Machinery International Trading
MIT Abuali GmbH
Langwies 25a
66802 Überherrn


kg
CE
mm
MPa
bar

**Pretendimi ankimor 3. Eskavator me zinxhir goma, minimum 8–10 ton (1 copë)-Pika H.**

OE ankues pretendon me rastin e dorëzimit të ofertës brenda afatit ligjor ka ngarkuar plotësisht të gjitha dokumentet e kërkuara nga dosja e tenderit dhe nga njoftimi për kontratë, përfshirë: Dudin doganor, Fotografitë e pajisjes, Dokumente të tjera përkatëse. Edhe këtu, AK kërkon sërish dokumentet ekzistuese. Ne i dorëzojmë edhe një herë më 03.12.2025. Autoriteti Kontraktues në përgjigjen e kërkesës për ri-shqyrtim, pretendon: se dokumenti paska qenë për "Mini Eskavator". Ky pretendim është i pavërtetë potencon ankuesi, sepse faktet reale, argumentojnë të kundërtën. Në dokumentin doganor figuron qartë përshkrimi "Track Excavator", që do të thotë Eskavator me zinxhir JO "mini".

- Pesha është 8,779 kg, pra brenda kriterit 8–10 ton.
- Askund, në asnjë dokument, nuk figuron termi "Mini Eskavator". Ky është krijim i AK-së.

Dokumentet janë zyrtare, me datë, me vulë dhe plotësisht të verifikueshme. Pra, pretendimi i AK është i pavërtetë, i fabrikuar dhe tregon që vendimi nuk është marrë mbi bazën e dokumenteve reale. Kjo është shkelje e rëndë e neneve 7, 59 dhe 61 të LPP-së. Fotografitë e bashkëngjitura nga kompania jonë, si me rastin e ofertimit, ashtu edhe me rastin e përgjigjes ndaj Kërkesës për Sqarim, dëshmojnë 100% se pajisja është eskavator me zinxhir gome, pikërisht sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Çdo element vizual konfirmon llojin e zinxhirit pa asnjë paqartësi. Po ashtu, dudi doganor e vërteton qartë peshën reale të pajisjes (8,779 kg), duke provuar përputhjen e plotë me kriterin 8–10 ton. Këto të dhëna e bëjnë të pamundur ngatërrimin me "mini eskavator" dhe rrëzojnë plotësisht pretendimin e pavërtetë të AK-së.

**Përgjigje në pretendimin ankimor 3. Ekspertja shqyrtuese** sqaron se në dosje të tenderit, tek "Kapaciteti teknik dhe professional", Kërkesa 5, pika h, AK ka kërkuar: **h. Eskavator me zingjir gome min 8-10ton min 1 cop.** Si dëshmi dokumentare është kërkuar: *"Deshmia 5.Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur original) operatori ekonime per autojmetet duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne original si* ***deshmi kopjet e dokumetit te registrimit per mjetet nga pika (a-e) dhe libreza****, dud doganor, fatur etj per mjetet nga pika (f-I). ".*

Bazuar në ofertën e OE ankues, konkretisht në dokumentin me titull "ESK-VOLVO ECR88D .pdf", është bashkangjitur fotografia e pajisjes, DUD-i në emër të OE ankues me përshkrimin e pajisjes dhe peshë 8778 kg dhe fatura blerëse e pajisjes nga OE ankues. Në bazë të kërkesës së AK dhe dokumenteve të bashkangjitura nga OE ankues me rastin e ofertimit, pretendimi i OE ankues **është i bazuar.**

## Arsimi Company SH.P.K.

• SPECIFIKAT E AUTOMJETIT •

– PRODHUESI: VOLVO
– TIPI: ECR 88D



Ferizaj
[illegible]@gmail.com
049/ 121 021
044/ 121 021

3042
DHEU BARDHË-TERMINAL

2 Eksportuesi Nr
GEUNS MACHINES BV
2490 BALEN/BE

IM 4

Referenca doganore
R 2325 17/02/2025
Manifesti 2025 1197

3: 1 1 | 4

5 Artikujt: 1 | 6 Nr. pakove: 1 | 7 Numri referues: 2025 #3

8 Marrësi / Importuesi Nr 812032770
Arsimi Company SH.P.K.
Greme, Rruga Shaban Viça, Pn.
Ferizaj

9 Personi përgjegjës Nr 812032770
Arsimi Company SH.P.K.
Greme, Rruga Shaban Viça, Pn.
Ferizaj

10 Vend. XK nga | 11 Vendi i XS | 12 Detajet e vlerës 0.00 | 13 P.P.B 1

14 Deklaruesi Nr 810644037
NTSH,, Albini "
Driton Islami
Ferizaj

15 Vendi dërgues/eksportues: BELGJIKA | 15 V.E. Kodi a BE b | 17 V.D. Rajoni a XK b
16 Vendi origjinës: SUEDIA | 17 Vendi i destinacionit: KOSOVA

18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në: VR129PB AC811VR XS | 19 no
20 Kushtet e dërgesës: EXW BE
21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon: VR129PB AC811VR XS
22 Valuta dhe shuma e: EUR 20,000.00 | 23 Kursi i: 1.0000000 | 24 Lloji i: 1 1 transakc.
25 Lloji: 30 në kufi | 26 Lloji: 30 Transport | 27 Transportuesi
28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e
29 Zyra doganore hyrëse/dalëse: 3041 PKK DHEU I BARDHË | 30 Lokacioni i mallrave

31 Paketimi dhe përshkrimi i mallit
Shenjat dhe numrat - Nr i kontejnerit - Numri dhe lloji
Shenja & nr VCE00E88E00212660
Kontejner
Numri dhe 1 NG
Lloji Pa paketim
Makineritë me rrotullim të superstruktures 360°, eskavatorët track -

Marka:Volvo,Tipi:ECR88D,me Lug reserve
Kw-43,Dyer-1,Ulese-1,Ngjyra Kuqe
Ore-3897,Viti Prodhimit-2017

32 Artikull: 1 Nr | 33 Numri tarifor: 84295210 00
34 Kodi origjinës: a SE b | 35 Pesha bruto (kg): 8,778.00 | 36
37 Procedura: 4000 000 | 38 Pesha Neto (kg): 8,778.00 | 39 Kuota
40 Dokumenti paraprak/lidok. përmbledhës: 2 | SE
41 Njësia plotësuese: PCE 1.00 | 42 Çmimi për njësi: 20,000.00 | 43 M.V. 5 bod
Kodi LSH | 45 Rregullimi: 1.439
46 Vlera Statistikore: 29,499.50

44 Inf. Dokument Certifikata dhe Autorizime
Nr. Licencës D.Vle. D.Sas.
500.00+0.00+0.00+0.00-0.00
D 380 934 935

derg parciale

47 Llog. taksave taksat

| Lloji | Baza e taksës | Norma | Shuma | M |
|---|---|---|---|---|
| CD | 29,499.500 | 0.000 | 0.00 | 1 |
| VT | 29,490.500 | 18.000 | 5,309.91 | 1 |
| | Totali | | 5,309.91 | 1 |

48 Llogaria e pagesës | 49 Identifikimi i depos

B DETAJET E LLOGARISE
Mënyra e pagesës KESH
Numri i Pranimit L 2322 Data 17/02/2025
Numri Pagesës P 879 Data 17/02/2025
Garancioni 0.00 EUR Data
Totali 0.00 EUR
Totali taksave 5,309.91 EUR

50 Principali Nr Nënshkrimi
C ZYRA DESTINIMIT
51 Zyrë zyrat e tranzitit vendi
Përfaqësuar nga
Vendi dhe data

52 ... nuk vlen
Kodi | 53 Zyra e destinacionit dhe vendi

D KONTROLL NGA ZYRA DOGANORE E DESTINACIONIT Vula:
54 Vendi dhe data
Deklaruesi emri / përfaqësuesi

Geuens machines BV
Puttestraat 8

2490 Balen
België
Tel : 003214888036
GSM : 0032495519317
Mail: info@geuensmachines.be
Fax : 003214888036

# Factuur

Balen, 27/01/2025
Nummer : 2500191

Arsimi Company SHPK
Rruga Shaban Vica

70000 Greme Ferizaj
Kosovo

BTW-nr.: 812032770
Ondernemingsnr.:

| | |
|---|---|
| Klantcode | KL11185 |
| Vervaldatum | 27/01/2025 |
| Betalingswijze | |

| Artikelcode | Omschrijving | Aantal | EHP ex. BTW | Bedrag ex. BTW | BTW |
|---|---|---|---|---|---|
| | graafmachine volvo ECR88D met 3 bakken<br>nr:VCE00E88E00212660<br>bouwjaar 2017 8778 kg<br><br>vrijstelling BTW export buiten EG | 1,00 | 20.000,00 | 20.000,00 | |

| % | Basis | BTW-bedrag |
|---|---|---|
| 0,00 | 20.000,00 | |

| | |
|---|---|
| Totaal ex. BTW | 20.000,00 |
| Totaal BTW | 0,00 |
| Totaal incl. BTW | 20.000,00 |
| Voorschot | 0,00 |
| Netto te betalen | 20.000,00 € |

**Ekspertja shqyrtuese** bazuar në shkresat e lëndës sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit kanë dorëzuar ankesë pranë OSHP-së, dy (2) operatore ekonomik, ankesa me numër të protokollit NR. 2025/1219 dhe 2025/1258. Sa i përket kësaj ankese Nr. NR. 2025/1219, ekspertja shqyrtuese vlerson se ankesa është e bazuar.

Në mbështetje të asaj që është cekur si më lartë, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, duke anuluar aktivitetin e prokurimit, ndonëse i kishte në dispozicion të gjitha dëshmitë dhe pajisjet e operatorit ekonomik ankues, të dorëzuara së bashku me ofertën. Andaj, rekomandoj që të anulohet njoftimi mbi anulim të kësaj procedure i datës 04.12.2025, dhe lënda të kthehet në rivlerësim ku vlerësimi i ofertave të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuar në dosjen e tenderit bazuar në nenin 59 të LPP-së. Njëkohësisht rekomandohet që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.

## 8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këte raport propozimi ynë është qe ankesa e OE ankues "Arsimi Company SH.P.K –Ferizaj, të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi i AK-së për anulim dhe lënda të kthehet në Ri Vleresim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues- Komuna e Shtimes
- Panelit Shqyrtues -OSHP.
- OE ankues -"Arsimi Company SH.P.K" –Ferizaj